



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 19543 Prot.

Lezhë, më 01 . 06 . 2021

VENDIM

Nr. 100 Datë 28 . 05 . 2021

“PËR NGRITJEN E KËSHILLIT ARTISTIKO-KULTUROR DHE TURISTIK, PËR SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË TIJ DHE MIRATIMIN E RREGULLORES SË FINANCIMIT TË PROJEKTEVE KULTURORE-ARTISTIKE DHE TURISTIKE NË BASHKINË LEZHË”

Në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 8, neni 9 pika 1.1, Neni 25, Neni 54 pika k, të Ligjit nr.10352 datë 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën”, Neni 5, pika 4, të VKM nr.540, datë 21.12.1992 “Për krijimin e Këshillave Artistiko-Kulturore dhe shpërblimin e anëtarëve të tyre”, i ndryshuar, pika 1, 2 dhe 4, si dhe në relacionin e Administratës së Bashkisë për krijimin e Këshillit Artistiko-Kulturor të Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

VENDOSI:

1. Të miratojë krijimin e Këshillit Artistiko-Kulturor dhe Turistik pranë Bashkisë Lezhë i përbërë nga 5 anëtarë.

- | | |
|-----------------|---------------------|
| 1- Frano Kulli | -shkrimtar |
| 2- Jak Gjini | -ekspert i turizmit |
| 3- Pjeter Marku | -muzikant |
| 4- Fran Laska | -poet |
| 5- Ardian Mashi | -piktor. |

2. Mandati i Këshillit artistiko-kulturor do të jetë ai i parashikuar në dispozitat ligjore në fuqi.

3. Anëtarët e Këshillit Artistiko-Kulturor dhe Turistik do të paguhen me një shpërblim prej 4 500 (katër mijë e pesëqind) lekë për çdo mbledhje, por jo më shumë se 6 mbledhje në vit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Burimi i financimit do të jetë buxheti i Bashkisë Lezhë i miratuar me vendim nr. 172 datë 27. 11. 2020. “Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 të Bashkisë Lezhë”.

4. Miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore-artistike sipas lidhjes bashkëngjitur.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI

ERNEST RAKAJ

